

5 Organizata të Shoqërisë Civile vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese duke kërkuar antikushtetutshmërinë e disa prej dispozitave të Ligjit nr. 80/2021 “Për regjistrimin e Organizatave Jofitimprurëse”

Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KSHH), Civil Right Defenders (CRD), Këshilli Shqiptar i Medias (KSHM), Aleanca Kundër Diskriminimit LGBT, Rrjeti Ballkanik për Gazetarinë Investigative Shqipëri (BIRN)

mbështetur në standardet më të mira ndërkombëtare të pasqyruara në Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut dhe Manualin Udhëzues të Komisionit të Venecias dhe OSBE/ODIHR për të drejtën dhe lirinë e organizimit, identifikuan disa dispozita anti-kushtetuese dhe jo konventore:

Neni 5, paragrafi 2 i Ligjit Nr. 80/2021

Këshillit të Ministrave i është deleguar e drejta për të nxjerrë një akt mbi miratimin e rregullave të detajuara për të dhënat parësore dhe dytësore, që regjistrohen në regjistrin elektronik për dhënësit e informacionit, ndërveprimin me bazat e tjera të të dhënave, si dhe për nivelin e aksesimit për subjektet e interesuara. Në vlerësimin tonë, ky delegim krijon paqartësi dhe pasiguri lidhur me të dhënat që mbahen për organizatën dhe aksesin te këto të dhëna nga persona të tretë.

1

Neni 8 i Ligjit Nr. 80/2021

Legjislacioni nuk duhet të detyrojë organizatat/shoqatat për të fituar personalitet ligjor, por duhet të krijojë mundësinë ligjore për ta bërë këtë. Fakti që dispozita e bën të detyrueshme regjistrimin brenda 30 ditëve nga data e themelimit, në të kundërt, organizata konsiderohet e paligjshme, në vlerësimin tonë nuk është në harmoni standardet ndërkombëtare.

2

Neni 9 i Ligjit Nr.80/2021

Ndalimi i parashikuar për regjistrimin e OJF-ve me emra ose shtesa dalluese që janë në kundërshtim me rendin ose me dispozitat urdhëruese të ligjit, në vlerësimin tonë, nuk është një parashikim ndalues i qartë dhe shterues, duke lënë hapësirë dhe diskrecion për autoritetet përkatëse, të cilat mund ta keqpërdorin për të refuzuar regjistrimin e një organizate në mënyrë të padrejtë.

3

Neni 17/3/a i Ligjit Nr. 80/2021

Kërkesat për regjistrimet e tjera të detyrueshme për organizatën jofitimprurëse që kryen regjistrimin fillestar, në veçanti ato për pasqyrat financiare vjetore, krijojnë një barrë për organizatën jofitimprurëse dhe mund të krijojnë pengesë për lehtësimin dhe promovimin e së drejtës për t'u organizuar.

4

Neni 20/2/c i Ligjit Nr. 80/2021

Ekzistenca e normave që referojnë në ligje të tjera, të identifikuar respektivisht në pikat 1 dhe 2/c të Nenit 20 të Ligjit, që lidhen me rastet e çregjistrimit të OJF-ve, krijojnë pasiguri ligjore pasi legjislacioni duhet të jetë më i qartë dhe shterues.

5

Neni 26, 28/6; 32 i Ligjit Nr. 80/2021

Kompetencat vendimmarrëse të dhëna Kancelarit të Gjykatës, nga nenet 26,28/6/32 të ligjit, konfundojnë dhe ndërhyjnë në kompetencat e pushtetit gjyqësor, si një autoritet vendimmarrës i pavarur dhe i paanshëm, në kuptimin e garancive të standarteve ndërkombëtare për OJF-të.

6

Neni 29 i Ligjit Nr. 80/2021

Natyra ngushtësisht formale e dispozitës që rregullon rastet e pezullimit të kërkesës për regjistrim të OJF-së, mund të çojë në pengesa në drejtim të lirisë së organizimit. Ligji nuk bën dallim midis kërkesave thelbësore për regjistrim me natyrë serioze nga kërkesat e tjera me natyrë formale dhe jo të domosdoshme. Për më tepër, diskrecioni i pezullimit nuk mund t'i atribuohet kancelarit si një nëpunës gjyqësor, por duhet të jetë atribut ekskluziv i gjykatës.

7

Neni 36 (pikat 1-2) i Ligjit Nr. 80/2021

Regjistrimi i njëkohshëm, i detyrueshëm sipas legjislacionit tatimor, të sigurimeve shoqërore e shëndetësore dhe atij të statistikave sipas formularëve përkatës mund të ngadalësojë procesin e regjistrimit dhe pengojë ushtrimin e veprimtarisë në mënyrë të lirë.

8

Neni 49 (pikat 2-6) i Ligjit Nr. 80/2021

Përcaktimi vetëm i dyshemesë së masës së gjobës jo më e vogël se 30.000 Lekë, por mungesa e përcaktimit të kufizimit maksimal të gjobës duke e lidhur me 1% e të ardhurave vjetore të organizatës nuk përmbush kërkesat e qartësisë dhe sigurisë ligjore që duhet të respektohen nga ligjvënësi, veçanërisht në formulimin dhe përcaktimin e sanksioneve ligjore.

9

Neni 50/5 i Ligjit Nr. 80/2021

Çregjistrimi automatik i OJF-ve, nga regjistri elektronik pas kalimit të afatit 12 mujor nga hyrja në fuqi e këtij ligji për ato raste kur OJF-të, nuk kanë detyrimin për t'u regjistruar në organet tatimore, konsiderohet masë ekstreme dhe përforcon edhe më shumë argumentet e dhëna më lart për kundërshtimin e nenit 8 të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore.

10